

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Sherbim ushqimor (vakt dreke) per te moshuarit Bashkia Puke**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Sherbime restaurant dhe shpërndarjeje ushqimesh 55300000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

2,046,000 (Dymilion e dyzet e gjashtëmijë) leke pa tvsh.

NE mbështetje te ligjit nr. 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. a. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 30% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3. a. Furnizime të ngjashme me një vlerë **me një vlerë jo më të vogël** se 20 % të **te vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit për përmbushje me sukses të kontratës të shoqëruar me kontratën e lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke parë vlerën e fondit limit për këtë objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedure vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kan furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Nuk e kalon vlerën e përcaktuar në ligj si dhe termi i përdorur jo më pak se 20% është sugjerim i Agjencisë së Prokurimit Publik. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

### 2.3.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër plotësimin e specifikimeve teknike si dhe të sasise se kërkuar sipas të gjitha standarteve dhe normave që parashikon legjislacioni në fuqi për përdorimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore për njerzit..
- Subjekti duhet të deklarojë se do marrë përsipër ofrimin e shërbimit pranë qendres sociale dhe të mundësojë shërbimin nepërmjet enëve përkatëse të guzhinës plastike, një përdorimshe dhe sipas standarteve dhe normave ushqimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri op.ekonomik merr përsipër angazhimin për plotësimin e kriterëve dhe kushteve teknik për zbatimin e objektit të kontratës sipas të gjithave standarteve ligjore për ofrimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore, si dhe ofrimin e këtij shërbimi pranë

vendit të përcaktuar nga Bashkia Puke në përputhje me projektin social që po zbaton aktualisht me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare në fondin social.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë objektin e veprimtarisë të përshatur për objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **Kriteri është vendosur për të garantuar që ofruesi i shërbimit ka si objekt të veprimtarisë së tij objektin e kërkuar në prokurim që garanton eksperiencën në zbatimin e objektit pasi vepron në këtë fushë.**

Specifikimet teknike janë të vendosura nga specialisti i përkatës në Njesinë e Prokurimit i cili ka hartuar dhe specifikimet dhe preventivin të përkatës për këtë objekt. Fondi limit është në përputhje me implementimin e kontratës për zbatimin e këtij projekti social ku janë përcaktuar vaktet ndërsa vlera ditore është në zbatim të shkresës nr.367/1 datë 13.02.2024 për përcaktimin e kuotave sipas VKM për grup moshat dhe konkretisht moshën e trete për të cilën do zbatohet ky projekt social. Menuja është përcaktuar nga punonjësit social sipas studimit të përkatës të tregut në përputhje me koston ditore për moshën e trete.

**Njesia Prokurimit**